



Tirane me, 15 Mars 2007

DEKLARATE PËR SHTYP

PRESIDENTI I REPUBLIKES TE DEKOROJE FEMIJEN QE SHPETOI DY JETE NJEREZISH NE AKSIDENTIN E DUKAGJINIT

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA / Defence for Children International, një nga organizatat kryesore në vend që punon për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të fëmijëve duke e bazuar punën e saj në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, shpreh keqardhjen e saj të thellë për aksidentin tragjik të ndodhur në segmentin rrugor Dukagjin-Shkodër, ku mes të tjerëve humbi jetën edhe një fëmijë 14 vjeçar.

CRCA shpreh ngushëllimet e saj për gjithë të afërmit e viktimave dhe në mënyrë të veçantë për familjen e 14 vjeçarit.

Në të njëjtën kohë CRCA është e lumtur që nga ky aksident tragjik mundën të mbijetonin dy fëmijet, Gëzim Cerina 15 vjeç dhe Marketin Kola 13 vjeç.

CRCA me anë të kësaj deklarate për shtyp kërkon të falenderojë publikisht aktin heroik të 15-vjeçarit Gëzim Cerina, i cili pasi kaloi me not lumin Kir, pas disa orësh arriti të dalë në rrugën automobilistike për të shpëtuar, jo vetëm jetën e tij, por edhe atë të dy personave të tjerë që kanë arritur të mbijetojnë nga aksidenti.

Nëpërmjet kësaj deklarate CRCA i kërkon Presidentit të Republikës së Shqipërisë të vlerësojë aktin heroik të 15 vjeçarit, Gëzim Cerina, nëpërmjet dhënies së një Medaljeje apo Dekorate, pasi nga përpjekjet e tij të guximshme, u shpëtuan edhe dy jetë të tjera njerëzore, një fëmijë dhe një i moshuar.

Ne besojmë se vlerësimi nga Presidenti i Republikës i 15-vjeçarit, Gëzim Cerina, do të jetë një burim frymëzimi për shumë fëmijë dhe të rinj në Shqipëri, për të kryer akte të tilla humane, siç është shpëtimi i jetës së njerëzve në aksidente apo situata të vështira.

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA

Adresa e CRCA: Pallatet e Shallvareve, Vila mbrapa Fushave të Tenisit, kati i 2-te, Tirane

Adresa postare: Kutia Postare 1738, Tirana / Albania

Tel/fax: 04 242264

E-mail: crca@crca.org.al

www.crca.org.al